



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Nr 698/1 prot.

Tiranë, më 24/04/2015

Drejtuar: **Z. Bujar LESKAJ**

KRYETAR I KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT

TIRANË

Lënda: Dërgohet informacion për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Në përgjigje të shkresës Tuaj nr 1034/6 datë 31.03.2015 ju informojmë se:

Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare është miratuar Urdhri nr. 41, datë 10.04.2015 “Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit“, ku janë përcaktuar masat konkrete dhe personat përgjegjës për përmbushjen e rekomandimeve Tuaja. Më hollësisht ju informojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1.Nga Bordi, ndryshimi i ligjit nr. 54, datë 29.05.2014, ku në nenin 27 “Përcaktimi i tarifave për subjektet e mbikëqyrura”, pika 3, cilësohet se “... Kur fondi i rezervës është në nivelin e përcaktuar në shkronjën “c”, të nenit 26 të këtij ligji, çdo tepricë që mbetet nga të ardhurat vjetore të Autoritetit njihet dhe regjistrohet si paradhënie e subjekteve të mbikëqyrura për periudhën pasardhëse, duke e shpërndarë në mënyrë përpjestimore me kontributin e tyre...”, i cili plotëson hapësirën midis përcaktimeve të nenit 26 të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, dhe nenit 27 ku citohet se “Ankimi i Vendimeve të Bordit nuk e pezullon ekzekutimin e tij. Pagesat, nëse vlerësohen të tepërta, i kthehen subjektit të mbikëqyrur”, duhet të lexohet me kujdes dhe duke e harmonizuar me kërkesën për hartimin e pasqyrave financiare bazuar në Standardet ndërkombëtare të Kontabilitetit gjykojmë si të domosdoshme që rezultati financiar të kalojë në fondet e veta ose në buxhetin e shtetit, si element i rëndësishëm që do të ndikojë në rritjen e përgjegjshmërisë institucionale në administrimin e fondeve në dispozicion.

1

Për këtë: Shprehemi se në parim jemi dakord që AMF të sigurojë pavarësi të plotë dhe të hartojë pasqyrat financiare në bazë të SNRF (shih komentin për rekomandimin 4). Përsa i takon trajtimit të tepricave (sasia që mbetet pasi nga të ardhurat janë zbritur shpenzimet dhe alokimet për fondin rezervë) shprehim edhe njëherë se kjo çështje është e rregulluar me ligjin “Për AMF”, i ndryshuar, i cili sanksionon kthimin përpjesëtimor me kontributin të subjektet e mbikëqyrura. Kalimi i tepricës në fondet e veta të AMF-së kërkon ndryshim ligjor. Ndërsa rekomandimi për kalimin e tepricës në buxhetin e shtetit nuk është në përputhje me synimin e sigurimit të pavarësisë financiare, do të zhbënte arritjen e realizuar me ndryshimin e ligjit të AMF-së dhe për rrjedhojë nuk jemi dakord me një rekomandim të tillë.

Gjithashtu e theksojmë edhe njëherë që arsyetimi nuk duhet të bëhet i njëanshëm duke marrë parasysh vetëm situatën kur AMF rezulton me tepricë ose në kushtet kur për qëllime praktike AMF ka aplikuar tarifën maksimale të njohur nga ligji, si dhe për shkak të kufizimeve ligjore (deri para se të kryheshin amendimet e ligjit të AMF-së) nuk ka qenë e mundur të kryheshin shpenzimet në nivel që i përputhet nevojave të AMF-së. Rregullimi ligjor në fuqi siguron përgjegjshmërinë e nevojshme institucionale për administrimin e fondeve në dispozicion.

Në përfundim shprehemi se nuk është i pranueshëm rekomandimi që tepricat të kalojnë në buxhetin e shtetit, sepse cenon pavarësinë. Mbajtja e tepricës për fondet e veta kërkon ndryshim ligjor, gjë që nuk është e përshtatshme të propozohet në kushtet kur ligji i AMF-së sapo është amenduar. Njëherësh mbajtja e të gjitha tepricave për fondet e veta dobëson mekanizmin e përgjegjshmërisë.

2. Nga institucioni të ndiqet një politikë e kujdesshme dhe e mirëpërcaktuar lidhur me mënyrën e krijimit, nivelin e kontributeve të paguara të cilat asnjëherë nuk duhet të tejkalojnë masën e kontributeve të detyrueshme të paguara për çdo punonjës si dhe mënyrën e administrimit të këtij fondi duke qenë të kujdesshëm për të eliminuar risqet lidhur me konfliktin e interesit.

Për këtë: Rekomandimi do të gjejë zbatim. Nga Autoriteti do të ndiqet një politikë e kujdesshme dhe e mirëpërcaktuar për nivelin e kontributeve të paguara.

3. Nga ana e autoritetit, të ndiqet në vijimësi arkëtimi i sanksioneve të vëna gjatë monitorimit të tregjeve duke siguruar në këtë mënyrë forcimin e rolit të mbikëqyrjes në tregjet financiarë në vend.

Për këtë: Janë marrë masat përkatëse dhe jemi në ndjekje të vazhdueshme për arkëtimin e gjobave të pambledhura.

4. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Sektori i Administrimit Financiare të marrë masat e duhura për hartimin e pasqyrave financiare bazuar në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit duke reflektuar statusin e një autoriteti të pavarur financiar si dhe të synohet drejt certifikimit të pasqyrave financiare nga ekspertë kontabël me eksperiencë ndërkombëtare dhe të familjarizuar me institucione financiare e sidomos trajtimet kontabël të aktivitetit të tyre.

Për këtë: Autoriteti ka patur komunikim shkresor me Ministrinë e Financave dhe Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit për ndryshimin e standardeve kontabël për hartimin e pasqyrave financiare.

Në zbatim të këtij rekomandimi, AMF do të vazhdojë të kërkojë nga organi kompetent në Republikën e Shqipërisë për të përcaktuar standardet kontabël për zbatim.

5. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë masat e duhura, për të bërë ndryshimin e strukturës organike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me akte administrative të brendshme, të përcaktojë delegimin e kompetencave apo, të detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Për këtë: Nga Autoriteti janë marrë masat dhe kanë filluar procedurat përkatëse të nevojshme. Në mbledhjen e Bordit të muajit prill 2015, do të miratohet Draft struktura organike.

6. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë masa të menjëhershme që në kushtet e një institucioni të pavarur të hartojë rregulla të qarta dhe mënyrën e dokumentimit të shpenzimeve të natyrës së përgjithshme në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” duke synuar gjithmonë minimizimin e angazhimeve financiare të panevojshme.

Për këtë: Vlerësojmë se shpenzimet e natyrës së përgjithshme janë të justifikuara, efektive dhe që synojnë rritjen e rendimentit të punës, me qëllim krijimin dhe sigurimin e kushteve optimale të punës.

7. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë masat e duhura që, për të gjithë rastet e riparimit të automjeteve, të bëjë hyrje në magazinë pjesët e këmbimit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

Për këtë: Rekomandimi ka gjetur zbatim. Sektori i Administrimit Financiar ka marrë masat, për të bërë hyrje në magazinë pjesët e këmbimit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

8. Struktura e Auditimit të Brendshëm të marrë masa që, në të ardhmen në programet e auditimit të përcaktojë dhe vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm mbi bazën e pesë komponenteve si, mjedisi i kontrollit, menaxhimit i riskut, aktivitetet e kontrollit, informacioni dhe komunikimi dhe monitorimi.

Për këtë: Pas dërgimit nga Autoriteti të deklaratës dhe raportit vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të pyetësorit të vetëvlerësimit në Ministrinë e Financave, Njësia e Auditimit të Brendshëm do të marrë masat e duhura për të kryer angazhime auditimi për vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

9. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të marrë masat që, para pagimit të faturës së mallit për blerje karburanti, të bëhet kontrolli i përqindjes së rritjes apo, të uljes së çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, si dhe cilësinë e karburantit, nëse është e njëjtë më atë të deklaruar nga operatori ekonomik në ofertën e tij, parashikuar në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VIII “Ekzekutimi i Kontratës”, pika 2, gërma c.

Për këtë: Rekomandimi do të gjejë zbatim menjëherë, ku për çdo procedurë blerje karburanti, përpara pagimit të faturës, do të bëhet kontrolli i çmimit të bursës.

10. Zyrtari i autorizuar, për fillimin e prokurimit të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve, të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit, në respekt të një përgjegjshmërie të lartë në administrimin e këtij procesi.

Për këtë: Rekomandimi do të gjejë zbatim. Autoriteti do të marrë masat për të siguruar një ndarje të qartë të përgjegjësisë ndërmjet njësisë prokurimit dhe komisionit të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

11. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimimit për çdo tender të zhvilluar, të hartojnë procesverbalin përmbledhës i cili të nënshkruhet prej tyre.

Për këtë: Rekomandimi ka gjetur menjëherë zbatim, procesverbalet përmbledhëse janë nënshkruar nga Kryetari dhe anëtarët e KVO-së.

12. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, të marrë masat që në ardhmen, çdo dokument që administrohet në dosjen e një procedure prokurimi, dhe që është në gjuhë të huaj, duhet të përkthehet në gjuhën shqipe dhe të noterizohet, kërkesë kjo e dispozitave ligjore në fuqi.

Për këtë: Rekomandimi do të gjejë zbatim menjëherë, dokumentat ligjore do të përkthehen në gjuhën shqipe dhe do të noterizohet, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

13. Pas përfundimit të procedurave të tenderimit, Njësia e Prokurimit të marrë masa për inventarizimin e dosjeve të prokurimit sipas modelit nr. 8, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat". Arkivimi i dosjeve të bëhet në përputhje me numrin rendor të objektit të prokurimit.

Për këtë: Rekomandimi do të gjejë zbatim menjëherë. Dosjet e prokurimit do të inventarizohen në përputhje me standardet ligjore në fuqi.

14. Në funksion të rritjes së cilësisë të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar, planin strategjik duke e azhurnuar atë çdo vit, i cili të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Për këtë: Rekomandimi do të gjejë zbatim menjëherë. Janë marrë masat e duhura dhe po punohet për përgatitjen e planit strategjik dhe planet e veprimit.

15. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të marrë masa për mbajtjen dhe derdhjen e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në **shumën 421 mijë lekë**, për raportet, mjekësore deri në 14 ditë dhe **shumën 5 mijë lekë** për tatimin mbi të ardhurat.

Për këtë: Shuma prej **421 mijë lekë** për raportet, mjekësore deri në 14 ditë dhe **5 mijë lekë** për tatimin mbi të ardhurat, nuk është e saktë. Nga raporti i auditimit të brendshëm, shuma është **169,435 lekë** përkatësisht për sigurime shoqërore e shëndetësore në vlerën 89,863 lekë dhe tatim mbi pagë në vlerën 79,572 lekë, pjesa e detyrimit për punëmarrësin. Ndërsa detyrimi për punëdhënësin është në shumën 125,523 lekë, pra në total 309,058 lekë.

Rekomandimi do të gjejë zbatim menjëherë. Nisur nga fakti se në muajin janar 2015 me implementimin e sistemit të ri informatik të administratës tatimore, nuk mund të kryhen sistemime për periudha të mëparshme, nga Autoriteti me shkresën nr. 810 prot, datë 20.04.2015,

drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore, është kërkuar asistencë për saktësimin e deklarave tatimore.

16. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë masat e duhura, për të caktuar nëpunësin autorizues që është përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxheteve të tyre, si dhe të caktojë nëpunësin zbatues, kordinatorin e riskut dhe grupin e menaxhimit strategjik (GMS) i cili ka për qëllim të diskutojë çështjet kryesore dhe mangësitë serioze me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave.

Për këtë: Rekomandimi ka gjetur menjëherë zbatim. Titullari i Autoritetit me urdhrin nr. 43, datë 17.04.2015, ka caktuar nëpunësin autorizues, kordinatorin e riskut dhe grupin e menaxhimit strategjik (GMS). Ndërsa me urdhrin nr. 44, datë 17.04.2015, është caktuar nëpunësi zbatues i AMF- së.

17. Për arritjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, institucioni të hartojë dhe programe specifike për ngritjen dhe forcimin e kapaciteve njerëzore që ka në dispozicion sidomos në fushat specifike të monitorimit të tregut financiar.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Financës, punonjësit të trajnohen dhe në kuptimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualit të dalë në zbatim të tij, pasi konstatoam se drejtuesit nuk zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe se ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk ka funksionuar në të gjitha hallkat e njësisë.

Të punohet për ngritjen e një sistemi informacioni që mbledh dhe dokumenton nevojat e çdo punonjësi për trajnim dhe nivelin e trajnimeve, të realizuara gjatë një viti dhe ta bëjë këtë indikator pjesë të vlerësimit periodik të punës së tyre.

Për këtë: Autoriteti po përgatit draft-strukturën ku është përcaktuar krijimi i Qendrës së Edukimit, e cila do të kontribuojë në rritjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, nëpërmjet programeve specifike. Gjithashtu, pas miratimit të strukturës së AMF-së, do të punohet për trajnimin e punonjësve në lidhje me ligjin e menaxhimit financiar dhe kontrollin.

18. Për të rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e riskut, në drejtim të identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut, njësia të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar strategjinë e riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht, të paktën 1 herë në 3 vjet, si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme, duke bërë kështu vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë.

Për këtë: Rekomandimi do të gjejë zbatim. Do të merren masat e duhura për përgatitjen e strategjisë së riskut.

19. Me qëllim që të ndihmohet menaxhimi për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të merren masat për të hartuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme.

Për këtë: Rekomandimi do të gjejë zbatim. Do të merren masat e duhura për të hartuar gjurmët e auditimit.

20. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë masa e duhura që, në të ardhmen të plotësojë dhe të dërgojë tek nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave, deklaratën dhe raportin vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, për veprimtarinë gjatë vitit të mëparshëm për njësinë publike që mbulon, si dhe pyetësonin e vetëvlërësimit, me qëllim që të ndihmojë njësinë, në identifikimin e atyre aspekteve të kontrollit të brendshëm, ku nevojitet të ndërmerret ndërgjegjësim i mëtejshëm dhe ku duhet të adresohen nevojat për trajnim.

Për këtë: Rekomandimi ka gjetur menjëherë zbatim, Autoriteti brenda muajit shkurt 2015, ka hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave deklaratën dhe raportin vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, për veprimtarinë e vitit 2014, si dhe pyetësonin e vetëvlërësimit.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të ndjekë procedurat ligjore për të kërkuar shpërblimin *për shumën 5,850 Euro, nga znj. Jona Mele*, për sa paguar për kryerjen e studimeve pasuniversitare (2 vjet) në Universitetin “Neë York Tirana”, në masën 90% të tarifës së shkollimit, shpenzime të cilat janë kryer jo në mbështetje të dispozitave ligjore.

Për këtë: sqarojmë se shpenzimi i kryer është në mbështetje të dispozitave ligjore. Vendimi i Bordit nr. 178, datë 13.12.2011, është në zbatim të nenit 14, pika 23 të ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Ky Vendim është bazuar në nenin 18 të Rregullores nr. 83, datë 29.06.2011 “Mbi marrëdhëniet financiare të punonjësve me AMF”, të miratuar nga Bordi i AMF –së, në të cilin citohet “Bordi me propozim të Kryetarit përcakton fushat e kualifikimit për kurset/ **studimet** apo trajnimet që do të financohen nga Autoriteti”, si dhe Rregullores nr.7, datë 30.08.2007 “Për rregullat e brendshme të AMF-së”. Mbështetja financiare për kualifikimin profesional të punonjësve që lidhen me fushën ku ata punojnë bazohet në politikën e burimeve njerëzore në AMF, dhe është në përputhje me të gjitha kriteret e përcaktuara për akordim të mbështetjes financiare.

Gjithashtu theksojmë se Vendimet e Bordit janë **vendime kolegjiale** dhe votimi për këtë rast ka qënë unanim.

Financimi i kryer për studimet pasuniversitare për *znj. Jona Mele*, nuk është rast përsëritur dhe është trajtuar në një periudhë të kaluar.

Rekomandimi juaj do ti paraqitet Bordit të AMF për shqyrtim.

Me konsideratë,

Enkeleda SHEHI

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

